

Liridon Hereqi

“INSTRUMENTET FINANCIARE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS, PROCEDURAT E LICENCIMIT DHE NDIKIMI I TYRE NË ZHVILLIMIN EKONOMIKO – SOCIAL”

Abstrakti

Instrumentet financiare paraqiten të një rëndësie të veçantë për çdo ekonomi, rëndësia e tyre rritet edhe më shumë në vendet që janë në proces zhvillimi, pasi që tek to përdorimi i këtyre instrumenteve ka një ndikim më të prekshëm në ekonominë e tyre. Për rrjedhojë, sikurse në çdo vend në zhvillim, edhe në Kosovë u ligjëruan instrumentet financiare duke lejuar përdorimin e tyre nëpërmjet institucioneve financiare dhe procedurave përkatëse të rregulluara përmes akteve ligjore dhe nënligjore. Ndikimi i tyre paraqitet si një e dhënë me rëndësi të veçantë jo thjesht në zhvillimin ekonomik të vendit, por sidomos në politikën ekonomike afatmesme dhe afatgjate që një vend i caktuar do të ndërmarrë. Për rrjedhojë, është e vetëkuptueshme se instrumentet financiare ndikojnë drejtpërdrejtë në ekonomi, duke dhënë shtysën e nevojshme e të domosdoshme për zhvillimin e saj, e kësaj edhe zhvillimin ekonomik-social, si një nga qëllimet kryesore të përdorimit të tyre. Gjithashtu aspekti rregullator përbën një nga çështjet më të rëndësishme për funksionalizimin e instrumenteve financiare, duke përcaktuar rregullat dhe procedurat që duhet të ndiqen me rastin e përdorimit të tyre nëpërmjet institucioneve financiare të licencuara. Përveç rregullave të përgjithshme të sanksionuara nga vetë shteti, duke filluar që nga përcaktimi i sistemit ekonomik nëpërmjet aktit më të lartë juridiko-politik, Kushtetutës, për të vijuar me ligjet dhe me aktet nënligjore, procedurat përcaktohen edhe nëpërmjet akteve rregullatore të institucioneve financiare të cilat përmes akteve të tyre të brendshme përcaktojnë edhe procedurat që aplikohen me rastin e përdorimit të instrumenteve financiare nga subjektet.

Fjalë kyçe: Instrumentet financiare, ekonomia, ligji, zhvillimi.